



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 162

Tiranë – E Martë, 21 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 8.10.2014	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2014..... 8207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 8.10.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake, në shtabe të ndryshme në Afganistan”, të ndryshuar..... 8207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 8.10.2014	Për përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit..... 8208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 8.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Vlorë”..... 8217
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 8.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Furnizimi me ujë dhe shërbimet sanitare në Orikum”..... 8220
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 8.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës - Pogradec - Qafë -Plloçë..... 8221
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 8.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Zgjerimi i rrugës së Elbasanit” (Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe e Tiranës)..... 8229
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 8.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.677, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik me erë (parqe eolike), dhënë shoqërisë “En.Ergy”, sh.p.k.”..... 8233
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 8.10.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 693, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik me erë (parqe eolike) dhënë shoqërisë “Power Wind Energy”, sh.p.k.”..... 8235

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 661, datë 8.10.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Skelë - Uji i ftohtë, bashkia Vlorë”.....	8236
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 8.10.2014	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike.....	8240
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 8.10.2014	Për vendosjen e autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik në varësi të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.....	8241
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 8.10.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 541, datë 7.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione, për festimet e 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendlit”	8241
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 8.10.2014	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) te Këshilli i Ministrave, për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit.....	8242

**VENDIM****Nr. 650, datë 8.10.2014****PËR SIGURIMIN E JETËS SË
USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA, QË DËRGOHEN NË
MISIONE USHTARAKE JASHTË
VENDIT, PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me shoqërinë e sigurimeve “INSIG”, sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2014.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe shoqëria e sigurimeve “INSIG”, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 651, datë 8.10.2014****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
532, DATË 7.7.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
OPERACIONE USHTARAKE, NË
SHTABE TË NDRYSHME NË
AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, miratuar në datën 26.6.2014, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1.8., të vendimit nr. 532, datë 7.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1.9., me këtë përmbajtje:

“1.9. Në Shtabin e Komandës Rajonale Qendrore (RC-C), në operacionin ushtarak “ISAF”, Kabul, Afganistan.

a) Misioni: Mbështetje dhe dhënie kontributi në funksione të ndryshme në Shtabin e Komandës Rajonale Qendrore, në operacionin ushtarak “ISAF”, Kabul, Afganistan.

b) Numri i pjesëmarrësve: 2 (dy) ushtarakë.

c) Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në datën 31.12.2014.

ç) Venddislokimi: në Shtabin e Komandës Rajonale Qendrore në Kaia, Kabul, Afganistan.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 652, datë 8.10.2014****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR KONTRATAT E PËRDORIMIT ME
AFAT, TË PRODUKTIT TË PUSHIMIT
AFATGJATË, RISHITJES APO
SHKËMBIMIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 42 e 61, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit, në mbështetje të neneve 42 e 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

2. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Kontratë ndihmëse”, kontrata, sipas së cilës konsumatori përfiton shërbimet që lidhen me një kontratë të përdorimit me afat apo me një kontratë të produktit të pushimit afatgjatë dhe të cilat ofrohen nga tregtari ose një palë e tretë sipas një marrëveshjeje midis asaj pale të tretë dhe tregtarit;

b) “Zotëruesi i kodit”, çdo njësi/entitet, përfshirë një tregtar apo grup tregtarësh, përgjegjës për hartimin dhe rishikimin e kodit të etikës dhe/ose për monitorimin e përputhshmërisë me kodin nga personat që janë zotuar ta respektojnë atë.

3. Në llogaritjen e kohëzgjatjes së një kontrate të përdorimit me afat apo të produktit të pushimit afatgjatë, sipas përcaktimit, përkatësisht, të pikave 1

dhe 2, të nenit 42, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, do të merret në konsideratë çdo dispozitë e kontratës që mundëson rinovimin apo shtyrjen/zgjatjen e nënkuptuar.

4. Në çdo publicitet për një kontratë apo grup kontratash të përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit duhet të përcaktohet mundësia e marrjes së informacionit të parashikuar në pikën 7, të këtij vendimi, dhe të tregohet burimi për gjetjen e këtij informacioni.

5. Në rastet kur një konsumatori i ofrohet një kontratë e përdorimit me afat, e produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit, personalisht, në një aktivitet promovimi apo shitjeje, tregtari duhet të deklarojë qartësisht në ftesë qëllimin tregtar dhe natyrën e aktivitetit.

Informacioni i përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, duhet të jetë i disponueshëm për konsumatorin në çdo kohë gjatë aktivitetit.

6. Një kontratë e përdorimit me afat apo një kontratë e produktit të pushimit afatgjatë nuk tregtohet apo nuk shitet si investim.

7. Tregtari, përpara lidhjes së kontratës sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, i siguron konsumatorit sipas rastit informacionin:

a) në rastin e kontratës të përdorimit me afat, nëpërmjet formularit standard të informacionit, të përcaktuar në shtojcën I, dhe informacionit shtesë, të përcaktuar në pjesën 3 të formularit;

b) në rastin e kontratës së produktit të pushimit afatgjatë, nëpërmjet formularit standard të informacionit, të përcaktuar në shtojcën II, dhe informacionit shtesë të përcaktuar në pjesën 3 të formularit;

c) në rastin e kontratës së rishitjes, nëpërmjet formularit standard të informacionit, të përcaktuar në shtojcën III, dhe informacionit shtesë të përcaktuar në pjesën 3 të formularit;

ç) në rastin e kontratës së shkëmbimit, nëpërmjet formularit standard të informacionit, të përcaktuar në shtojcën IV, dhe informacionit shtesë të përcaktuar në pjesën 3 të formularit.

8. Tregtari i siguron konsumatorit informacionin e përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, pa pagesë, në letër apo nëpërmjet një mjeti tjetër të qëndrueshëm, lehtësisht të arritshëm dhe të disponueshëm për konsumatorin.

9. Tregtari e përgatit informacionin e përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, në gjuhën

¹ Direktiva 2008/122/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 14 janarit 2009 për mbrojtjen e konsumatorëve, në lidhje me disa aspekte të kontratave të përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit (Ref: Numri Celex: 32008LO122; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 33, datë 3.2.2009).



shqipe dhe/ose në gjuhën e vendit në të cilin konsumatori është rezident, sipas preferencës së këtij të fundit, me kusht që ajo gjuhë të jetë gjuhë zyrtare e Bashkimit Evropian.

10. Tregtari, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, i siguron konsumatorit kontratën e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit.

11. Nëse konsumatori është rezident në Republikën e Shqipërisë, kontrata hartohet në gjuhën shqipe. Nëse konsumatori ka kombësi tjetër, gjuha e përdorur në kontratë zgjidhet sipas preferencës së konsumatorit, me kusht që kjo gjuhë të jetë gjuhë zyrtare e BE-së.

12. Në rastin e kontratës së përdorimit me afat për një pronë/pasuri specifike të paluajtshme, e cila gjendet në territorin e një vendi tjetër, tregtari i siguron konsumatorit një përkthim të certifikuar të kontratës në gjuhën e vendit ku gjendet prona/pasuria, me kusht që kjo gjuhë të jetë gjuhë zyrtare e BE-së.

13. Informacioni i përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, është pjesë përbërëse e kontratës dhe nuk pëson asnjë ndryshim, me përjashtim të rastit kur palët shprehimisht bien dakord ndryshe ose kur ndryshimet janë rrjedhojë e rrethanave të jashtëzakonshme apo të paparashikuara, përtej kontrollit të tregtarit, pasojat e të cilit nuk mund të ishin shmangur edhe në rastin e ushtrimit të të gjithë kujdesit të nevojshëm.

14. Ndryshimet në kontratën e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit do t'i komunikohen konsumatorit përpara lidhjes së kontratës në letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm lehtësisht të arritshëm dhe të disponueshëm prej tij. Kontrata përmban shprehimisht këto ndryshime.

15. Kontrata e përdorimit me afat, e produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit, të paktën, përmban:

a) informacionin e përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi;

b) çdo ndryshim të informacionit sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, të ndodhur në përputhje me pikën 13, të këtij vendimi;

c) identitetin, vendbanimin dhe nënshkrimin e secilës prej palëve;

ç) datën dhe vendin e lidhjes së kontratës;

d) një formular standard të veçantë të heqjes dorë nga kontrata, sipas përcaktimeve të shtojcës V të këtij vendimi për qëllim të lehtësimit të ushtrimit të heqjes dorë nga kontrata.

16. Tregtari, përpara lidhjes së kontratës, në mënyrë të qartë, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, njofton konsumatorin për ekzistencën e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata, kohëzgjatjen e periudhës së heqjes dorë, referuar pikave 19-22, të këtij vendimi, dhe ndalimin e parapagesave gjatë periudhës së heqjes dorë nga kontrata, referuar pikave 27-28, të këtij vendimi.

17. Faqja apo faqet korresponduese të kontratës së përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit, që përmbajnë kushtet kontraktuale të lidhura me ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata, kohëzgjatjen e periudhës së heqjes dorë dhe ndalimin e parapagesave gjatë kësaj periudhe, do të nënshkruhet/n nga konsumatori.

18. Konsumatori në momentin e lidhjes së kontratës merr një ose disa kopje së saj. Në kontratë parashikohet edhe numri i kopjeve.

19. Periudha e heqjes dorë nga kontrata e përdorimit me afat, e produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit, që fillon sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, përfundon sipas rastit:

a) pas një viti e 14 (katërbëdhjetë) ditësh në rast se tregtari nuk ka plotësuar formularin e veçantë standard të heqjes dorë nga kontrata, sipas përcaktimeve të shkronjës “d”, të pikës 16, të këtij vendimi, dhe nuk ia ka siguruar atë konsumatorit me shkrim, në letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm;

b) pas tre muajsh e 14 (katërbëdhjetë) ditësh në rast se tregtari nuk i ka siguruar konsumatorit me shkrim, në letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm, informacionin e përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, përfshirë formularin standard të informacionit të përcaktuar në shtojcat I - IV.

20. Në rast se tregtari plotëson formularin e veçantë standard për heqjen dorë nga kontrata, sipas shkronjës “d”, të pikës 16, të këtij vendimi, dhe ia siguron atë konsumatorit me shkrim, në letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm, brenda një viti nga dita sipas përcaktimeve të



pikës 4, të nenit 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, periudha e heqjes dorë nga kontrata fillon nga data kur konsumatori merr formularin.

21. Në rastin kur tregtari i ka siguruar konsumatorit me shkrim, në letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm, informacionin e përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, përfshirë formularin standard të informacionit, të përcaktuar në shtojcat I - IV, brenda tre muajve nga dita sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, periudha e heqjes dorë fillon nga data kur konsumatori e merr një informacion të tillë.

22. Në rast se kontrata e shkëmbimit i ofrohet konsumatorit bashkërisht dhe në të njëjtën kohë me kontratën e përdorimit me afat, vetëm një periudhë e heqjes dorë nga kontrata zbatohet për të dyja llojet e kontratave.

23. Në rastin kur konsumatori ka qëllim të ushtrojë të drejtën e tij të heqjes dorë nga kontrata, konsumatori njofton tregtarin me letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm për vendimin e tij, përpara përfundimit të periudhës së heqjes dorë nga kontrata, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, dhe të pikave 19-22, të këtij vendimi.

24. Konsumatori mund të përdorë formularin standard të heqjes dorë nga kontrata, të përcaktuar në shtojcën V të këtij vendimi, e cila i është dhënë nga tregtari në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 16, të këtij vendimi. Afati konsiderohet i përmbushur nëse njoftimi bëhet përpara se të përfundojë periudha e heqjes dorë nga kontrata.

25. Ushtrimi nga ana e konsumatorit i së drejtës së heqjes dorë nga kontrata i jep fund detyrimit të palëve për përmbushjen e kontratës.

26. Në rastin kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, konsumatori nuk ngarkohet me asnjë kosto dhe nuk ka asnjë përgjegjësi për çfarëdo vlere që i korrespondon shërbimit, i cili mund të jetë kryer përpara heqjes dorë.

27. Në kontratat e përdorimit me afat, produktit të pushimit afatgjatë dhe atyre me shkëmbim është e ndaluar kryerja nga konsumatori e çdo parapagese, sigurim i garancive, rezervim parash në llogari, njohje e

qartë/e shprehur e borxhit apo çdo pagesë/shpërblim tjetër për tregtarin apo një palë tjetër, përpara përfundimit të periudhës së heqjes dorë.

28. Në kontratat e rishitjes është e ndaluar që tregtari ose një palë e tretë të kërkojë apo të marrë nga konsumatori çdo parapagesë, dhënie garancie, rezervim të parave në llogari, njohje të shprehur të borxhit apo çdo pagesë/shpërblim tjetër për tregtarin, përpara shitjes faktike apo përpara përfundimit të kontratës së rishitjes.

29. Për kontratat e produktit të pushimit afatgjatë, pagesa bëhet me këste në përputhje me një kalendar pagesash. Çdo pagesë e çmimit të specifikuar në kontratë, e ndryshme nga parashikimi i këtij kalendari, është e ndaluar. Pagesat, përfshirë çdo tarifë anëtarësimi, do të ndahen në këste vjetore, ku secili këst ka të njëjtën vlerë. Tregtari i dërgon konsumatorit një kërkesë me shkrim për pagesën, me letër ose me një mjet tjetër të qëndrueshëm, të paktën katërmëdhjetë ditë kalendarike përpara çdo date të caktuar.

30. Duke nisur nga kësti i dytë e në vijim, konsumatori mund ta përfundojë kontratën pa penalizim, përmes një njoftimi që i bën tregtarit, brenda katërmëdhjetë ditëve nga data e marrjes së kërkesës së pagesës për çdo këst. Kjo e drejtë nuk ndikon të të drejtat për përfundimin e kontratës, sipas legjislacionit në fuqi.

31. Në rastin kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata e përdorimit me afat apo produktit të pushimit afatgjatë, çdo kontratë shkëmbimi që lidhet me të apo çdo kontratë tjetër ndihmëse konsiderohet automatikisht e përfunduar, pa asnjë kosto për konsumatorin.

32. Konsumatori nuk privohet nga mbrojtja që i jep ligji nr.9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, dhe ky vendim, edhe në rastet kur ligji i zbatueshëm në kontratë është ai i një shteti tjetër, sipas parashikimit në dispozitat e legjislacionit shqiptar mbi të drejtën ndërkombëtare private, nëse:

a) pasuria e paluajtshme, për të cilën bëhet fjalë, gjendet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo të një shteti anëtar të BE-së;

b) për kontrata që nuk lidhen drejtpërdrejt me pasurinë e paluajtshme, tregtari ushtron veprimtari tregtare apo profesionale në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar apo me çfarëdo



mënyre drejton këto aktivitete për Shqipërinë dhe kontrata është brenda gamës së këtyre aktiviteteve.

33. Në rast shkeljeje të kërkesave të pikave 10-14 dhe 16-18, të këtij vendimi, kontrata e përdorimit me afat, e produktit të pushimit afatgjatë dhe atyre me shkëmbim konsiderohet e pavlefshme dhe shfuqizohet.

Çdo heqje dorë e konsumatorit nga të drejtat e dhëna sipas këtij vendimi konsiderohet e pavlefshme dhe shfuqizohet.

34. Për çështjet, që nuk janë të rregulluara me nenet 42 e 43, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, dhe me këtë vendim zbatohen dispozitat e pjesës V, “Kontratat”, të Kodit Civil.

35. Çdo pretendim për ndalimin e shkeljes në bazë të këtij vendimi në lidhje me veprimet ose praktikatat tregtare, që prekin interesat e konsumatorëve, do të paraqitet sipas kushteve dhe në zbatim të nenit 55, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, i ndryshuar.

36. Vendimi nr. 833, datë 8.7.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme”, shfuqizohet.

37. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I
FORMULARI STANDARD I
INFORMACIONIT PËR KONTRATAT E
PËRDORIMIT ME AFAT

Pjesa 1

Identiteti, vendbanimi dhe statusi juridik i tregtarit që do të jetë palë e kontratës;

Një përshkrim i shkurtër i produktit (si p.sh. përshkrim i pasurisë së paluajtshme);

Natyra ekzakte dhe përmbajtja e së drejtës/drejtave);

Periudha e saktë, brenda së cilës mund të ushtrohet e drejta që është objekt i kontratës në fjalë dhe nëse është e nevojshme dhe kohëzgjatja e saj;

Data në të cilin konsumatori mund të fillojë ushtrimin e të drejtës kontraktuale;

Në rast se kontrata ka të bëjë me një pronë specifike që është në ndërtim e sipër, data kur strehimi dhe shërbimet/komoditetet të kenë përfunduar/të jenë bërë të disponueshme;

Çmimi që do të paguhet nga konsumatori për përfitimin e së drejtës (drejtave);

Përshkrim i kostove shtesë të detyrueshme të përcaktuara në kontratë; lloji i kostove dhe të dhëna/tregues për shumat (si p.sh. tarifa vjetore, tarifa të tjera korrente, taksa të posaçme, taksa lokale);

Një përmbledhje e shërbimeve kryesore që janë të disponueshme për konsumatorin (si p.sh. energjia elektrike, uji, mirëmbajtja, mbledhja e plehrave) dhe një e dhënë/tregues mbi shumën që do të paguhet nga konsumatori për këto shërbime;

Një përmbledhje e komoditeteve që janë në dispozicion të konsumatorit (si p.sh. pishina apo sauna);

A janë këto komoditete të përfshira në kostot e sipërpërmendura?

Në rast se “jo”, specifikoj çfarë është e përfshirë dhe çfarë është për t’u paguar;

A është e mundur të bësh pjesë në një skemë shkëmbimi?

Në rast se përgjigja është “po”, specifikoj emrin e skemës së shkëmbimit;

Një e dhënë/tregues mbi kostot për anëtarësim /shkëmbim;

A ka firmosur tregtari kod etike dhe në rast se “po”, ku mund të gjendet?

Pjesa 2, informacion i përgjithshëm

Konsumatori ka të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, pa dhënë arsye, brenda 14 ditëve kalendarike nga dita e lidhjes së kontratës ose çdo kontrate paraprake detyruese, apo nga marrja e këtyre kontratave, në rast se kjo ndodh më vonë.

Gjatë kësaj periudhe të heqjes dorë nga kontrata ndalohet çdo parapagesë nga ana e konsumatorit. Ndalimi ka të bëjë me çdo lloj shpërblym, duke përfshirë pagesën, dhënie të garancive, rezervim parash në llogari, njohjen e shprehur të borxhit etj. Këtu përfshihet jo vetëm pagesa për tregtarin, por edhe për palët e treta.

Konsumatori nuk përballet me asnjë kosto apo detyrim, përveç atyre të specifikuara në kontratë.



Në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të së drejtës private, kontrata mund të zbatohet një ligj të ndryshëm nga ai shqiptar, që mund të jetë ligj i një shteti anëtar të BE-së, ose i një shteti tjetër. Në rastet e mosmarrëveshjeve të mundshme, konsumatori mund t'u drejtohet përveç gjykatave të shtetit shqiptar, ku banon zakonisht apo është rezident, dhe gjykatave të shteteve të tjerë.

Nënshkrimi i konsumatorit:

Pjesa 3, informacion shtesë

Informacionin të cilin konsumatori ka të drejtë ta ketë, si dhe ku ai mund të gjendet (kështu p.sh. në cilin kapitull të një broshure të përgjithshme), në rast se nuk parashikohet më poshtë:

1. INFORMACION MBI TË DREJTAT E PËRFTUARA

Kushtet që përcaktojnë ushtrimin e së drejtës që është objekt i kontratës dhe informacion në lidhje me faktin nëse kushtet janë përmbushur apo jo, dhe në rast se nuk janë përmbushur, cilat kushte mbeten për t'u përmbushur.

Rastin kur kontrata parashikon të drejta për strehim/akomodim, të përzgjedhur nga një sërë akomodimesh, informacion mbi kufizimet e aftësisë së konsumatorit për të përdorur në çdo kohë akomodimin nga kjo seri akomodimesh.

2. INFORMACION MBI PASURITË

Në rastet kur kontrata ka të bëjë me një pasuri specifike të paluajtshme, një përshkrim të saktë dhe të hollësishëm të asaj prone dhe vendndodhjes së saj; në rastin kur kontrata ka të bëjë me një numër pronash (*multi-resort*), një përshkrim të përshtatshëm të pasurive dhe vendndodhjes së tyre; në rastin kur kontrata ka të bëjë me akomodim, përveç pasurisë së paluajtshme, një përshkrim të përshtatshëm të akomodimit dhe komoditeteve.

Shërbimet (si p.sh. energjia elektrike, uji, mirëmbajtja, mbledhja e mbeturinave), ndaj të cilave konsumatori ka apo do të ketë akses dhe sipas cilave kushteve.

Sipas rastit kur është e zbatueshme, komoditetet e përbashkëta, si p.sh. pishina, sauna, etj., ndaj të cilave konsumatori ka ose mund të ketë akses dhe sipas cilave kushte.

3. KËRKESA SHITESË PËR AKOMODIM/STREHIMIN NË NDËRTIM/TË PAFËRUNDUAR (NË RASTIN KUR ZBATOHET)

Gjendja e përfunduar e akomodimit/strehimit dhe shërbimeve që e bëjnë atë plotësisht funksionale (energji elektrike, ujë, lidhje telefonike dhe gaz) dhe çdo komoditet tjetër ku do të ketë akses konsumatori;

Afati për përfundimin e strehimit /akomodimit dhe shërbimeve që do ta bëjnë atë plotësisht funksionale (energji elektrike, ujë, lidhje telefonike dhe gaz) dhe një afat i arsyeshëm për përfundimin e çdo komoditeti, në të cilin do të ketë akses konsumatori;

Numri i lejes së ndërtimit dhe emri dhe adresa e plotë e autoritetit apo autoriteteve kompetente;

Garancia në lidhje me përfundimin e akomodimit/strehimit ose një garanci në lidhje me rimbursimin e çdo pagese që bëhet nëse akomodimi/strehimi nuk përfundohet dhe kushtet që përcaktojnë funksionimin e këtyre garancive, në rastin kur është e përshtatshme.

4. INFORMACION MBI KOSTOT

Një përshkrim i saktë dhe i përshtatshëm i të gjitha kostove që lidhen me kontratën e përdorimit me afat; mënyra sesi këto kosto do t'i caktohen konsumatorit dhe sesi dhe kur mund të rriten këto kosto; metoda për përlllogaritjen e shumës së detyrimeve që lidhen me zotërimin e pronës, pagesat e detyrueshme ligjore (si p.sh. taksat dhe tarifrat) dhe shpenzimet administrative (si p.sh. menaxhimi, mirëmbajtja dhe riparimet).

Në rastin kur është e zbatueshme, informacion mbi faktin nëse ka ndonjë detyrim, hipoteke, barrë, apo ndonjë pengesë tjetër si garanci pagese e regjistruar, në lidhje me të drejtën e akomodimit/strehimit.

5. INFORMACION MBI ZGJIDHJEN E KONTRATËS

Informacion, në rast se është e përshtatshme, mbi marrëveshjet/masat për zgjidhjen e kontratave ndihmëse dhe pasojat e kësaj zgjidhjeje;

Kushtet e zgjidhjes së kontratës, pasojat e zgjidhjes dhe informacioni mbi çdo detyrim të konsumatorit mbi kostot që mund të lindin nga kjo zgjidhje.



6. INFORMACION SHITESË

Informacion mbi mënyrën sesi bëhet mirëmbajtja dhe riparimet e pronës, dhe si funksionon administrimi dhe menaxhimi i saj, duke përfshirë edhe faktin, nëse dhe si konsumatorët mund të ndikojnë dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me këto çështje;

Informacion mbi faktin nëse është e mundur apo jo pjesëmarrja në një sistem për rishitjen e të drejtave kontraktuale;

Informacion në lidhje me sistemin përkatës dhe të dhëna mbi kostot që lidhen me rishitjen përmes këtij sistemi;

Informacion mbi gjuhën/gjuhët, për komunikim me tregtarin në lidhje me kontratën, si p.sh. në lidhje me vendimet për menaxhimin, rritjen e kostove dhe trajtimin e pyetjeve dhe ankesave;

Mundësia për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës, në rastin kur është zbatueshme.

Pranim i marrjes së informacionit

Nënshkrimi i konsumatorit

SHTOJCA II

FORMULARI STANDARD PËR INFORMACION MBI KONTRATËN E PRODUKTTIT TË PUSHIMIT AFATGJATË

Pjesa 1

Identiteti, vendbanimi dhe statusi juridik i tregtarit(ve) që do të jetë palë e kontratës;

Një përshkrim i shkurtër i produktit;

Natyrë ekzakte dhe përmbajtja e së drejtës/drejtave;

Periodha e saktë brenda së cilës mund të ushtrohet e drejta që është objekt i kontratës në fjalë dhe nëse është e nevojshme dhe kohëzgjatja e saj;

Data në të cilin konsumatori mund të fillojë ushtrimin e të drejtës kontraktuale;

Çmimi për t'u paguar nga konsumatori për përfundimin e së drejtës (drejtave), duke përfshirë çdo kosto që konsumatori pret, si rrjedhojë e së drejtës për akses në strehim/akomodim, udhëtim dhe çdo produkt apo shërbim tjetër i lidhur me to, sipas specifikimeve;

Kalendari i pagesave me këste, që përcakton shumën të barabartë të kësteve të këtij çmimi, për

çdo vit të kohëzgjatjes së kontratës dhe datat kur ato duhet të paguhen;

Pas vitit të parë, shumat në vijim mund të përshtaten për të garantuar ruajtjen e vlerës reale të atyre kësteve, si p.sh. për marrjen në konsideratë të inflacionit;

Përshkrim i kostove të detyrueshme shtesë të përcaktuara sipas kontratës; lloji i kostove dhe të dhënat mbi shumat (si p.sh. tarifa anëtarësimi vjetor);

Përmbledhje e shërbimeve kryesore që i ofrohen konsumatorit (si p.sh. uljet në çmim për ditët e qëndrimit në hotel dhe fluturimet);

A janë të përfshira ato në kostot e sipër përmendura?

Në rast se “jo”, specifikohet së çfarë është e përfshirë dhe çfarë është me pagesë (si p.sh. në tarifën e anëtarësimit vjetor është përfshirë në kosto qëndrimi për tri net, e gjithë pjesa tjetër e akomodimit duhet të paguhet veçmas).

A ka firmosur tregtari kod etike, dhe në rast se “po” ku mund të gjendet?

Pjesa 2, informacion i përgjithshëm

Konsumatori ka të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, pa dhënë arsye, brenda 14 ditëve kalendrike nga dita e lidhjes së kontratës ose çdo kontrate paraprake detyruese, apo nga marrja e këtyre kontratave, në rast se kjo ndodh më vonë.

Gjatë kësaj periudhe të heqjes dorë nga kontrata ndalohet çdo parapagesë nga ana e konsumatorit. Ndalimi ka të bëjë me çdo lloj shpërblimi, duke përfshirë pagesën, dhënien e garancive, rezervim parash në llogari, njohjen e shprehur të borxhit etj. Këtu përfshihet jo vetëm pagesa për tregtarin, por edhe për palët e treta.

Konsumatori ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës, pa penalizim, duke njoftuar për tregtarin, brenda 14 ditëve kalendrike nga marrja e kërkesës për pagesë për çdo këst vjetor.

Konsumatori nuk përballet me asnjë kosto apo detyrim, përveç atyre të specifikuara në kontratë.

Në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të së drejtës private, kontrata mund të zbatohet një ligj të ndryshëm nga ai shqiptar, që mund të jetë ligj i një shteti anëtar të BE-së, ose i një shteti tjetër. Në rastet e mosmarrëveshjeve të mundshme, konsumatori mund t'u drejtohet përveç gjykatave të shtetit shqiptar, ku ai banon



apo është rezident, dhe gjykatave të shteteve të tjerë.

Nënshkrimi i konsumatorit

Pjesa 3, informacion shtesë

Informacion të cilin konsumatori ka të drejtë ta ketë, si dhe ku ai mund të gjendet (kështu p.sh. në cilin kapitull të një broshure të përgjithshme), në rast se nuk parashikohet më poshtë:

1. INFORMACION MBI TË DREJTAT E PËRFTUARA

Një përshkrim i duhur dhe i saktë i zbritjeve të çmimit për prenotime të ardhshme, të cilat ilustrohen përmes një sërë shembujsh të ofertave të fundit;

Informacion mbi kufizimet e mundësisë së konsumatorit për të përdorur të drejtat, si p.sh. disponueshmëri e kufizuar apo oferta sipas parimit “kush vjen i pari, shërbehet i pari”, kufizime për sa i përket kohëzgjatjes së promocioneve të caktuara dhe uljeve të veçanta.

2. INFORMACION MBI ZGJIDHJEN E KONTRATËS

Informacion, në rast se është e përshtatshme, mbi marrëveshjet/masat për zgjidhjen e kontratave ndihmëse dhe pasojat e kësaj zgjidhjeje;

Kushtet e zgjidhjes së kontratës, pasojat e zgjidhjes dhe informacioni mbi çdo detyrim të konsumatorit, mbi kostot që mund të lindin nga kjo zgjidhje.

3. INFORMACION SHITESË

Informacion mbi gjuhën/gjuhët, për komunikim me tregtarin në lidhje me kontratën, si p.sh. në lidhje me vendimet për menaxhimin, rritjen e kostove dhe trajtimin e pyetjeve dhe ankesave;

Mundësia për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës, në rastin kur është zbatueshme.

Pranimi i marrjes së informacionit.

Nënshkrimi i konsumatorit

SHTOJCA III FORMULARI STANDARD I INFORMACIONIT PËR KONTRATAT E RISHITJES

Pjesa 1

Identiteti, vendbanimi dhe statusi juridik i tregtarit(ëve) që do të jenë pjesë e kontratës

Një përshkrim i shkurtër i shërbimeve (si p.sh. marketingu);

Kohëzgjatja e kontratës;

Çmimi që do të paguhet nga konsumatori për përfitimin e shërbimeve;

Një përshkrim i kostove të detyrueshme shtesë, që janë pjesë e kontratës; lloji i kostove dhe të dhëna për shumat (si p.sh. taksa lokale, tarifa të noterit, kosto publiciteti);

A ka nënshkruar tregtari një kod etik dhe në rast se “po” ku mund të gjendet ai?

Pjesa 2, informacion i përgjithshëm

Konsumatori ka të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, pa dhënë arsye, brenda 14 ditëve kalendrike nga dita e lidhjes së kontratës ose çdo kontrate paraprake detyruese, apo nga marrja e këtyre kontratave, në rast se kjo ka ndodh më vonë.

Gjatë kësaj periudhe të heqjes dorë nga kontrata ndalohet çdo parapagesë nga ana e konsumatorit. Ndalimi ka të bëjë me çdo lloj shpërblimi, duke përfshirë pagesën, dhënien e garancive, rezervim parash në llogari, njohjen e shprehur të borxhit etj. Këtu përfshihet jo vetëm pagesa për tregtarin, por edhe për palët e treta.

Konsumatori nuk përballlet me asnjë kosto apo detyrim, përveç atyre të specifikuara në kontratë.

Në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të së drejtës private, kontrata mund të zbatohet një ligj të ndryshëm nga ai shqiptar, që mund të jetë ligj i një shteti anëtar të BE-së, ose i një shteti tjetër. Në rastet e mosmarrëveshjeve të mundshme, konsumatori mund t’u drejtohet përveç gjykatave të shtetit shqiptar, ku ai banon apo është rezident, dhe gjykatave të shteteve të tjerë.

Nënshkrimi i konsumatorit



Pjesa 3, informacion shtesë

Informacionin të cilin konsumatori ka të drejtë ta ketë, si dhe ku ai mund të gjendet (kështu p.sh. në cilin kapitull të një broshure të përgjithshme), në rast se nuk parashikohet më poshtë:

Kushtet e zgjidhjes së kontratës, pasojat e zgjidhjes dhe informacioni mbi çdo detyrim të konsumatorit, mbi kostot që mund të lindin nga kjo zgjidhje;

Informacion mbi gjuhën/gjuhët, për komunikim me tregtarin në lidhje me kontratën, si p.sh. në lidhje me vendimet për menaxhimin, rritjen e kostove dhe trajtimin e pyetjeve dhe ankesave;

Mundësia për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit, në rastin kur është zbatueshme.

Pranim i marrjes së informacionit.

Nënshkrimi i konsumatorit

SHTOJCA IV FORMULAR STANDARD I INFORMACIONIT PËR KONTRATAT E SHKËMBIMIT

Pjesa 1

Identiteti, vendbanimi dhe statusi juridik i tregtarit që do të jetë palë e kontratës;

Një përshkrim i shkurtër i produktit;

Natyra ekzakte dhe përmbajtja e së drejtës/drejtave;

Periudha e saktë, brenda së cilës mund të ushtrohet e drejta që është objekt i kontratës dhe nëse është e nevojshme dhe kohëzgjatja e saj;

Data në të cilin konsumatori mund të fillojë ushtrimin e të drejtës kontraktuale;

Çmimi që duhet të paguhet nga konsumatori për tarifën e anëtarësimit në kontratën e shkëmbimi;

Përshkrim i kostove shtesë të detyrueshme të përcaktuara në kontratë; lloji i kostove dhe të dhëna/tregues për shumat (si p.sh. tarifa për rinovim, tarifa të tjera korrente, taksa të posaçme, taksa lokale);

Një përmbledhje të shërbimeve kryesore që janë në dispozicion të konsumatorit;

A janë këto shërbime të përfshira në kostot e sipërpërmendura?

Në rast se “jo”, specifiko çfarë është e përfshirë dhe çfarë është për t’u paguar (lloji i kostove dhe të dhëna/tregues për shumat; si p.sh. një përlllogaritje e çmimit për transaksionet individuale të shkëmbimit, duke përfshirë edhe çdo tarifë shtesë);

A ka firmosur tregtari kod etike dhe në rast se “po”, ku mund të gjendet?

Pjesa 2, informacion i përgjithshëm

Konsumatori ka të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, pa dhënë arsye, brenda 14 ditëve kalendarike nga dita e lidhjes së kontratës ose çdo kontrate paraprake detyruese, apo nga marrja e këtyre kontratave, në rast se kjo ka ndodh më vonë. Në rastin kur kontrata e shkëmbimit ofrohet bashkërisht dhe në të njëjtën kohë me kontratën e përdorimit me afat, zbatohet vetëm një periudhë e vetme e heqjes dorë për të dyja kontratat.

Gjatë kësaj periudhe të heqjes dorë nga kontrata ndalohet çdo parapagesë nga ana e konsumatorit. Ndalimi ka të bëjë me çdo lloj shpërblimi, duke përfshirë pagesën, dhënien e garancive, rezervim parash në llogari, njohjen e shprehur të borxhit etj. Këtu përfshihet jo vetëm pagesa për tregtarin, por edhe për palët e treta.

Konsumatori nuk përballet me asnjë kosto apo detyrim, përveç atyre të specifikuara në kontratë.

Në përputhje me jurisprudencën/legjislacionin ndërkombëtar të së drejtës private, kontrata mund të zbatohet një ligj të ndryshëm nga ai shqiptar. Në rastet e mosmarrëveshjeve të mundshme, konsumatori mund t’u drejtohet përveç gjykatave të shtetit shqiptar dhe gjykatave të shteteve të tjerë.

Nënshkrimi i konsumatorit

Pjesa 3, informacion shtesë

Informacion të cilin konsumatori ka të drejtë ta ketë, si dhe ku ai mund të gjendet (kështu p.sh. në cilin kapitull të një broshure të përgjithshme), në rast se nuk parashikohet më poshtë:

1. INFORMACION MBI TË DREJTAT E PËRFTUARA

Shpjegim mbi mënyrën sesi funksionon sistemi i shkëmbimit; mundësitë dhe modalitetet e shkëmbimit; një e dhënë mbi vlerën që i caktohet konsumatorit të përdorimit me afat, në



sistemin e shkëmbimit, dhe disa shembuj të mundësive për shkëmbim;

Të dhëna për numrin e resorteve të disponueshme dhe numrin e anëtarëve të sistemit të shkëmbimit, përfshirë çdo kufizim që lidhet me disponueshmërinë e strehimit/akomodimit të posaçëm të zgjedhur nga konsumatori, p.sh. si rrjedhojë e pikut/kulmit të periudhave të kërkesës, nevoja potenciale për të rezervuar shumë kohë përpara dhe të dhëna mbi çdo kufizim që ka lidhje me zgjedhjen që rezulton nga të drejtat e përdorimit me afat të vendosura në sistemin e shkëmbimit nga konsumatori.

2. INFORMACION MBI PRONAT/PASURITË

Në rastet kur kontrata, përveç pasurisë së paluajtshme, ka të bëjë me akomodimin/strehimin, një përshkrim i shkurtër dhe i saktë i pronave dhe vendndodhjes së tyre; përshkrim i saktë i akomodimit/strehimit dhe komoditeteve; një përshkrim se ku konsumatori mund të gjejë informacion shtesë.

3. INFORMACION MBI KOSTOT

Informacion në lidhje me detyrimin e tregtarit për të dhënë hollësi/detaje përpara se shkëmbimit të jetë fiksuar, për çdo shkëmbim të propozuar, për çdo tarifë shtesë për të cilën konsumatori është përgjegjës, në zbatim të shkëmbimit.

4. INFORMACION MBI ZGJIDHJEN E KONTRATËS

Informacion, në rast se është e përshtatshme, mbi marrëveshjet/masat për zgjidhjen e kontratave ndihmëse dhe pasojat e kësaj zgjidhjeje;

Kushtet e zgjidhjes së kontratës, pasojat e zgjidhjes dhe informacioni mbi çdo detyrim të konsumatorit, mbi kostot që mund të lindin nga kjo zgjidhje.

5. INFORMACION SHITESË

Informacion mbi gjuhën/gjuhët, për komunikim me tregtarin në lidhje me kontratën, si p.sh. në lidhje me vendimet për menaxhimin, rritjen e kostove dhe trajtimin e pyetjeve dhe ankesave;

Mundësia për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës, në rastin kur është zbatueshme;

Pranimi i marrjes së informacionit.

Nënshkrimi i konsumatorit

SHTOJCA V E DREJTA E HEQJES DORË

Konsumatori ka të drejtën për të hequr dorë nga kontrata brenda 14 ditëve kalendarike pa dhënë asnjë arsye.

E drejta për të hequr dorë nga kontrata nis që nga(për t'u plotësuar nga tregtari, përpara se t'ia kalojë formularin konsumatorit).

Në ato raste kur konsumatori nuk e ka marrë këtë formular, periudha e heqjes dorë nis ditën kur konsumatori ka marrë këtë formular, por në çdo rast ajo përfundon pas një viti dhe 14 ditë kalendarike.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: objekte

Nr.	Pronari			Z. K	Nr.	OBJEKTE	SIP. NDËRTIMI TOTALE (M ²)	SIPËRFAQJA E BANESËS(M ²)	ÇMIMI MESATAR (LEKË/M ²)	VLERA SIPAS ÇMIMIT MESATAR	VLERA TOTALE (LEKË)	EMERTIMI	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Vlera në leke Sipas preventivit						OBJEKTEVE	
1	LULEZIM	JUSUF	BRAHJA	3266	23/11	3,837,957					3,837,957	KARBURANTI (PJESËRISHT)	LEJE NDËRTIMI
2	FATOS	SELMAN	BRAHJA	3266	23/7	9,103,865.0	317.4 ^{m2}	88.9	89,492.0	7,955,838.8	17,059,704	BANESË, LOKAL 3KT	KONFIRMIM ZVRPP
3	PËRPARIM	SALI	JAKU	8190	11/25	2,917,505	170m ²	85	94,523	8,034,455	10,951,960	BANESË 1KT + PODRUM	KONTRATË SHITBLERJE "GEKOS" SHPK
4	NDOC	BAFTI	GJONAJ	8190	9/262	4,843,934	105.7m ²				4,843,934	LOKAL, DYQAN 2KT	KONFIRMIM ZVRPP
			TOTALI			20,703,261.0					36,693,554.8		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSIOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT”
(FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE, TIRANË)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Shënime
	TIRANE Z.K. 8280									
1	Shoqeria "Gener 2" Shpk			8280	2/99	Truall	19	23950	455050	Konfirmim ZVRPP
2	Lavdie		Çaushti	8280	2/152	Truall	26	23950	622700	Konfirmim ZVRPP
3	Bp. Mita & Bejleri			8280	2/182	Truall	61	23950	1460950	Konfirmim ZVRPP
4	Bp. Zadeja			8280	2/318	Truall	46	23950	1101700	Konfirmim ZVRPP
5	Bp. Tundo			8280	2/183	Truall	102	23950	2442900	Konfirmim ZVRPP
6	Tomson		Xhelili	8280	2/329	Truall	59	23950	1413050	Konfirmim ZVRPP
7	Vitore		Gruhn	8280	2/137	Truall	40	23950	958000	Konfirmim ZVRPP
8	Lluka		Rashkovic	8280	2/116	Truall	19	23950	455050	Konfirmim ZVRPP
	TIRANË Z.K. 8190									
9	Liza		Mati	8190	9/1,	Truall	173	36197	6262081	Konfirmim ZVRPP
10	Liza		Mati	8190	9/18,	Truall	10	36197	361970	Konfirmim ZVRPP
11	Ndoc	Bahti	Gjonaj	8190	9/262	Truall	49	36197	1773653	Konfirmim ZVRPP
12	Shoqeria "Ferald" shpk			8190	11/361	Truall	206	36197	7456582	Konfirmim ZVRPP
13	Osman Rami		Tomja Qebej	8190	11/367	Truall	276	36197	9990372	Konfirmim ZVRPP
14	Liman		Gjoka	8190	11/858	Truall	421	36197	15238937	Konfirmim ZVRPP
15	Andi		Gjoka	8190	11/853	Truall	180	36197	6515460	Konfirmim ZVRPP
16	Hysni		Miha	8190	11/854	Truall	270	36197	9773190	Konfirmim ZVRPP
17	Gjergj		Gjeloshaj	8190	11/359	Truall	136	36197	4922792	Konfirmim ZVRPP
18	Bp. Stermasi, Mulleti, Kazazi			8190	11/356	Truall	20	36197	723940	Konfirmim ZVRPP
19	Drini		Baboci	8190	11/357	Truall	314	36197	11365858	Konfirmim ZVRPP
20	Bp. Stermasi, Mulleti, Kazazi			8190	11/450	Truall	41	36197	1484077	Konfirmim ZVRPP
21	Bp. Stermasi, Mulleti, Kazazi			8190	11/451	Truall	154	36197	5574338	Konfirmim ZVRPP
	TIRANË Z.K. 8160									
22	Bp. Frasheri			8160	5/81,	Truall	49	57126	2799174	Konfirmim ZVRPP
23	Shtet			8160	5/86,	Truall	127	57126	7255002	Konfirmim ZVRPP
24	Aida		Visari + bp	8160	5/106	Truall	61	57126	3484686	Konfirmim ZVRPP
25	Fatos		Babo	8160	5/84,	Truall	99	57126	5655474	Konfirmim ZVRPP
26	Franc		Gozhita	8160	5/105	Truall	27	57126	1542402	Konfirmim ZVRPP
27	Trashegimtare Lubonja			8160	5/107	Truall	8	57126	457008	Konfirmim ZVRPP
28	Demi		Allamani	8160	5/108	Truall	14	57126	799764	Konfirmim ZVRPP



29	Pronar i pavartetuar			8160	5/112	Truall	10	57126	571260	Konfirmim ZVRPP
	FSHATI SAUK Z.K. 3266									
30	Shoqeria "Krel's Luck" shpk			3266	24/5	Truall	61	3283	200263	Konfirmim ZVRPP
31	Shoqeria "Krel's Luck" shpk			3266	24/13	Are	53	230	12190	Konfirmim ZVRPP
32	Lulezim	Jusuf	Brahja	3266	23/11	Truall	229	3283	751807	Konfirmim ZVRPP
33	Skender	Jusuf	Brahja	3266	23/13	Truall	229	3283	751807	Konfirmim ZVRPP
34	Majlinda	Jusuf	Brahja	3266	23/12	Truall	99	3283	325017	Konfirmim ZVRPP
35	Hetem	Nuredin	Brahja	3266	23/8	Truall	610	3283	2002630	Konfirmim ZVRPP
	Halit	Nuredin	Brahja							
36	Artan	Sotirag	Burda	3266	24/14	Are	19	230	4370	Konfirmim ZVRPP
37	Shoqeria "Krel's Luck" shpk			3266	24/15	Are	157	230	36110	Konfirmim ZVRPP
38	Fatos	Selman	Brahja	3266	27/3	Truall	207	3283	679581	Konfirmim ZVRPP
39	Nazmi	Hasan	Tresa	3266	22/3	Are	85	230	19550	Konfirmim ZVRPP
	SHUMA						4766		117700745	



VENDIM
Nr. 659, datë 8.10.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.677, DATË 16.8.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË
NDËRTIMIT TË CENTRALIT
ELEKTRIK ME ERË (PARQE
EOLIKE), DHËNË SHOQËRISË
“EN.ERGY”, SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.677, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

b) Në autorizimin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Në pikën 4, fjalët “... brenda datës 31 dhjetor 2015 ...” zëvendësohen me “... brenda datës 31 dhjetor 2022, në përputhje me afatet e zërave të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve, bashkëlidhur këtij autorizimi ...”.

ii. Pas shkronjës “e”, të pikës 8, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë. “EN.ERGY”, sh.p.k., nuk respekton afatet dhe kushtet e përcaktuara në grafikun e punimeve.”.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AKTIVITETI	PERIUDHA		
NIVELI 1	DATA E FILLIMIT	Kohëzgjatja (dd)	DATA E MBARIMIT
Përgatitja e kantiert	9/1/2016	50	10/21/2016
Rrugët e lidhjes	10/22/2016	352	10/9/2017
Themelet	4/11/2017	445	6/30/2018
Kanali i kavos midis kullave eolike	3/1/2018	443	5/18/2019
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni	5/15/2019	240	1/10/2020
Kullat eolike dhe aerogjeneratore	1/10/2020	963	8/30/2022
Linja e transmetimit Elbasan-Durrës*	7/1/2020	729	6/30/2022
Punime përgatitore dhe vepra aksesore linja e interkoneksionit Durrës-Puglia	2/1/2019	434	4/10/2020
Pozicionimi i kavos detare nga Durrësi për linjën e interkoneksionit	4/10/2020	933	10/30/2022
Vepra të ndryshme plotësuese	3/1/2018	1720	11/15/2022
Kontrollet e sigurisë së punimeve	9/1/2016	2281	11/30/2022
Kolaudimi i brendshëm	10/9/2017	1878	11/30/2022
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjën e interkoneksionit 500 MW AL-IT	11/30/2022	31	12/31/2022
Zgjerimi në 1.000 MW i linjës së interkoneksionit Durrës-Puglia	3/3/2025	576	9/30/2026
Kolaudimi i brendshëm zgjerimi nga 500 MW në 1,000 MW linja e interkoneksionit	9/30/2026	30	10/30/2026
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi në 1,000 MW linja e interkoneksionit AL-IT	10/30/2026	31	11/30/2026
*Ky programim është i lidhur me programimin për linjën e transmetimit dhe linjën e interkoneksionit			

**Parku eolik Gracen Programimi i kohës Aktivitetet kryesore
dd te nevojshme per cdo sektor punues**

■ PERIUDHA Kohëzgjatja (dd)

*Ky programim është i lidhur me programimin për linjën e transmetimit dhe linjën e interkoneksionit

Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi në 1,000 MW linja e interkoneksionit AL-IT

Kolaudimi i brendshëm zgjerimi nga 500 MW në 1,000 MW linja e interkoneksionit

Zgjerimi në 1.000 MW i linjës së interkoneksionit Durrës-Puglia

Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjën e interkoneksionit 500 MW AL-IT

Kolaudimi i brendshëm

Kontrollet e sigurisë së punimeve

Vepra të ndryshme plotësuese

Pozicionimi i kavos detare nga Durrësi për linjën e interkoneksionit

Punime përgatitore dhe vepra aksesore linja e interkoneksionit Durrës-Puglia

Linja e transmetimit Elbasan-Durrës*

Kullat eolike dhe aerogjeneratore

Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni

Kanali i kavos midis kullave eolike

Themelet

Rrugët e lidhjes


Përgatitja e kantiert



AKTIVITETI	PERIUDHA		
NIVELI 1	DATA E FILLIMIT	Kohezgjatja (dd)	DATA E MBARIMIT
Përgatitja e kantierit	9/1/2016	50	10/21/2016
Rrugët e lidhjes	10/22/2016	352	10/9/2017
Themelet	4/11/2017	445	6/30/2018
Kanali i kavos midis kullave eolike	3/1/2018	443	5/18/2019
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni	5/15/2019	240	1/10/2020
Kullat eolike dhe aerogjeneratorët	1/10/2020	963	8/30/2022
Linja e transmetimit Elbasan-Durrës	7/1/2020	729	6/30/2022
Punime përgatitore dhe vepra aksesore Linja e interkoneksionit Durrës-Puglia	2/1/2019	434	4/10/2020
Pozicionimi i kavos detare nga Durrësi për linjën e interkoneksionit	4/10/2020	933	10/30/2022
Vepra të ndryshme plotësuese	3/1/2018	1720	11/15/2022
Kontrollet e sigurisë së punimeve	9/1/2016	2281	11/30/2022
Kolaudimi i brendshëm	10/9/2017	1878	11/30/2022
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjën e interkoneksionit 500 MW AL-IT	11/30/2022	31	12/31/2022
Zgjerimi në 1.000 MW i linjës së interkoneksionit Durrës-Puglia	3/3/2025	576	9/30/2026
Kolaudimi i brendshëm zgjerimi nga 500 MW në 1,000 MW linja e interkoneksionit	9/30/2026	30	10/30/2026
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi në 1,000 MW linja e interkoneksionit AL-IT	10/30/2026	31	11/30/2026


Parku eolik Paper Programimi i kohës Aktivitetet kryesore
dd te nevojshme per cdo sektor punues

PERIUDHA Kohezgjatja (dd)



Parku eolik Shushica Programimi i kohës Aktivitetet kryesore
dd te nevojshme per cdo sektor punues

PERIUDHA Kohezgjatja (dd)






AKTIVITETI	PERIUDHA		
	DATA E Fillimit	Konsegjente (dd)	DATA E Mbarimit
Pergatitja e kantierit	2016-09-01	50	2016-10-21
Rruget e lidhjes	2016-10-22	352	2017-10-09
Themelet	2017-04-11	445	2018-06-30
Kanali i kavos midis kullave eolike	2018-03-01	443	2019-05-18
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nenstacioni	2019-05-15	240	2020-01-10
Kullat eolike dhe aerogjeneroret	2020-01-10	963	2022-08-30
Linja e transmetimit Elbasan-Durres*	2020-07-01	729	2022-06-30
Punime perqatitore dhe vepra aksesore Linja e interkoneksionit Durres-Puglia	2019-02-01	434	2020-04-10
Pozicionimi i kavos detare nga Durresi per Linjen e interkoneksionit	2020-04-10	933	2022-10-30
Vepra te ndryshme plotesuese	2018-03-01	1720	2022-11-15
Kontrollet e sigurise se punimeve	2016-09-01	2281	2022-11-30
Kolaudimi i brendshem	2017-10-09	1878	2022-11-30
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjen e interkoneksionit 500 MW AL-IT	2022-11-30	31	2022-12-31
Zgjerimi ne 1.000 MW i linjes se interkoneksionit Durres-Puglia	2025-03-03	576	2026-09-30
Kolaudimi i brendshem zgjerimi nga 500 MW ne 1.000 MW linja e interkoneksionit	2026-09-30	30	2026-10-30
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi ne 1.000 MW linja e interkoneksionit AL-IT	2026-10-30	31	2026-11-30

Parku eolik Tregan Programimi i kohes Aktivitetet kryesore
dd te nevojshme per cdo sektor punues

Ky programim eshte i lidhur me programimin per linjen e transmetimit dhe linjen e interkoneksionit Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi ne 1.000 MW linja e interkoneksionit AL-IT Kolaudimi i brendshem zgjerimi nga 500 MW ne 1.000 MW linja e interkoneksionit Zgjerimi ne 1.000 MW i linjes se interkoneksionit Durres-Puglia Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjen e interkoneksionit 500 MW AL-IT Kolaudimi i brendshem Kontrollet e sigurise se punimeve Vepra te ndryshme plotesuese Pozicionimi i kavos detare nga Durresi per Linjen e interkoneksionit Punime perqatitore dhe vepra aksesore Linja e interkoneksionit Durres-Puglia Linja e transmetimit Elbasan-Durres Kullat eolike dhe aerogjeneroret Linja e lidhjes nga parku eolik tek nenstacioni Kanali i kavos midis kullave eolike Themelet Rruget e lidhjes Pergatitja e kantierit

PERIUDHA Kohezgjatja (dd)



VENDIM

Nr. 660, datë 8.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 693, DATË 16.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE) DHËNË SHOQËRISË "POWER WIND ENERGY", SHPK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 693, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministria e Energjisë dhe Industrisë".

b) Në tekstin "Autorizim", bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Në pikën 4, fjalët "... brenda datës 31.12.2014 ..." zëvendësohen me "... brenda datës 31.12.2022, në përputhje me afatet e zërave të punës, sipas grafikut të zbatimit të punimeve, bashkëlidhur këtij autorizimi ...".

ii. Pas shkronjës "e", të pikës 8, shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) "Power Wind Energy", sh.p.k.", nuk respekton afatet dhe kushtet e përcaktuara në grafikun e punimeve."


2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



AKTIVITETI	PERIUDHA		
NIVELI 1	DATA E FILLIMIT	Kohezgjatja (dd)	DATA e MBARIMIT
Përgatitja e kantierit Libohovë	9/1/2016	50	10/21/2016
Rrugët e lidhjes	10/22/2016	352	10/9/2017
Themelet	4/11/2017	445	6/30/2018
Kanali i kavos midis kullave eolike	3/1/2018	443	5/18/2019
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni	5/15/2019	240	1/10/2020
Kullat dhe aerogjeneratorët	1/10/2020	963	8/30/2022
Punime parapërgatitore dhe vepra aksesore linja e interkoneksionit 500 MW Shqipëri-Greqi	2/1/2019	434	4/10/2020
Linja e interkoneksionit nga 500 MW Shqipëri-Greqi	4/10/2020	933	10/30/2022
Vepra të ndryshme plotësuese	3/1/2018	1720	11/15/2022
Kontrollet e sigurisë së punimeve	9/1/2016	2281	11/30/2022
Kolaudimi i brendshëm	10/9/2017	1878	11/30/2022
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjen e interkoneksionit 500 MW AL-GR	11/30/2022	31	12/31/2022



VENDIM

Nr. 661, datë 8.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, SKELE - UJI I FTOHTË, BASHKIA VLORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 3, 4 dhe 6, të vendimit nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen e truallit 24 392 (njëzet e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) m², për sipërfaqen e ndërtimit 3 422.55 (tre mijë e katërqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë e pesë) m².

Faqe| 8236

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 442 851 979 (katërqind e dyzet e dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh të përballohet, si më poshtë vijon:

a) Fondi prej 225 235 631 (dyqind e njëzet e pesë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një) lekësh, nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, planifikuar në buxhetin e vitit 2014, për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës;

b) Fondi prej 217 616 348 (dyqind e shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet e tetë) lekësh, nga fondet e miratuara për investime për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Shpenzimet procedurale, në vlerën prej 645 000 (gjashtëqind e dyzet e pesë mijë) lekësh, të përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

...

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët janë bërë shënimet “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” dhe “Saktësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë bashkisë Vlorë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONE PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA
NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "SKELE - UJË I FTOHTE BASHKIA VLORE"

(Zona I, Skelë ~ Shkolla e Marinës)

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi Leke/m ²		Vlera			SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Ndërtesë	Banese	
1	Namik Mustafai	8602	27/256	7.5		10,174		76,305			Konfirmuar nga ZVRPP
2	Bashkëpronare Dauti	8602	27/456	28.5		10,174		289,959			Konfirmuar nga ZVRPP
3	Margarita Baba	8602	27/435/1	56		10,174		569,744			Konfirmuar nga ZVRPP
4	Vllasi Dardha	8602	27/510	132		10,174		1,342,968			Konfirmuar nga ZVRPP
5	B.P Kapllanaj	8602	27/377	3.45	88.5	10,174	58,028	35,100		5,135,478	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Halil Çobaj	8602	27/534		191		58,028	-		11,083,348	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Gjolek Bushi	8602	23/159	405.2		10,174		4,122,505		-	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Gjolek Bushi	8602	23/156	127		10,174		1,292,098		-	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Pallat në Bashkëpronësi	8602	23/98		52.5		58,028	-		3,046,470	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Hader Hoxha	8602	27/553	114.7	32	10,174	58,028	1,166,958		1,856,896	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Stili Pazaj	8602	26/40	240		10,174		2,441,760		-	Saktesim dokumentacioni
12	Gezim Gjonaj	8602	27/551	98.6		10,174		1,003,156		-	Konfirmuar nga ZVRPP
13	B.Pronësi Gjonbocari	8602	23/125	628		10,174		6,389,272		-	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Mazo Gjonzeneli	8602	23/9	115		10,174		1,170,010		-	Konfirmuar nga ZVRPP
15	B.Pronësi me 35 pronare	8602	26/30	1890.1		10,174		19,229,877		-	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Ramiz Shehu	8602	26/22-T	1047.7		10,174		10,659,300		-	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Sulejman Shehi	8602	26/22-Nd		150		58,028		5,330,599		Konfirmuar nga ZVRPP
18	Vasil Kuçi	8602	27/102	499		10,174		5,076,826		-	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Safet Abazi	8602	26/168	227		10,174		2,309,498		-	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Safet Abazi	8602	26/169	190		10,174		1,933,060		-	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Agentina Hoxha	8602	26/170	8		10,174		81,392		-	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Agentina Hoxha	8602	26/165	82.2		10,174		836,303		-	Saktesim dokumentacioni
23	B.Pronësi me 35 pronare	8602	26/37	1492.3		10,174		15,182,660		-	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Tahir Hysni Saraseli	8602	26/11	182	38	10,174	58,028	1,851,668		2,205,064	Saktesim dokumentacioni
25	B.P. Kokoshi	8602	26/12	880		10,174		8,953,120		-	Konfirmuar nga ZVRPP
26	B.P.35 pronare	8602	26/55	450		10,174		4,578,300		-	Saktesim dokumentacioni
27	Albin Mone	8602	27/27	22.2		10,174		225,863		-	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Ilirjan Sheremeti	8602	27/316	5.6		10,174		56,974		-	Konfirmuar nga ZVRPP
29	B.P.Kokoshi	8602	31/31	1145		10,174		11,649,230		-	Saktesim dokumentacioni
30	Bashkëpronare Minga	8602	23/190	898.6		10,174		9,142,356		-	Konfirmuar nga ZVRPP
31	Thimio Lavanditi	8602	27/415		73.56	10,174	58,028	-		4,268,540	Saktesim dokumentacioni
32	Albert Hoxha	8602	27/550	125.3	16	10,174	58,028	1,274,802		928,448	Konfirmuar nga ZVRPP
33	Armand Mishgioni	8602	31/84	200	200	10,174		2,034,800	6,107,095		Konfirmuar nga ZVRPP
34	Petraq dhe Sofie Deçka	8602	27/250+1-2		26.4	10,174	58,028	-		1,531,939	Konfirmuar nga ZVRPP
					27	10,174		-	888,057		
35	BP Vrekaj	8602	27/250+1-3		47.2		58,028	-		2,738,922	Konfirmuar nga ZVRPP
36	B.P. Muço	8602	27/47	44	170	10,174	58,028	447,656		9,864,760	Konfirmuar nga ZVRPP
37	Skender Koçi	8602	23/11		30	10,174	58,028	-	1,168,690		Konfirmuar nga ZVRPP
38	Shkelzen+Kujtim Selimi	8602	23/27-t	432	132.25	10,174		4,395,168	14,702,384	-	Saktesim dokumentacioni



39	Posta shqiptare sh.a.	8602	27/48-N1, 27/48-N4		50.5		58,028	-	1,554,259		Konfirmuar nga ZVRPP
40	Albtelecom sh.a.	8602	27/48-N2		18.0		58,028	-	553,993		Konfirmuar nga ZVRPP
41	Banka e Kursimeve nr.4	8602	27/48-N3		24.0		58,028	-	738,658		Konfirmuar nga ZVRPP
42	Bashkëpronesi Ciro	8602	27/48+1-2		69.25		58,028	-		4,018,439	Konfirmuar nga ZVRPP
43	Bashkëpronesi Paraj	8602	27/250+1-1		22.4		58,028	-		1,299,827	Konfirmuar nga ZVRPP
44	Bashkëpronesi Hamzaj	8602	27/53+1-1	9.2	40.5	10,174	58,028	93,601		2,350,134	Saktesim dokumentacioni
45	Bashkëpronar Risilia	8602	27/48		75.8		58,028			4,395,621	Saktesim dokumentacioni
46	Bashkëpronare Nushi	8602			40.4		58,028	-		2,344,331	Konfirmuar nga ZVRPP
47	Merita Dine	8602	23/99+1-2		50.7		58,028	-		2,942,020	Konfirmuar nga ZVRPP
48	Bashkëpronare Jahaj	8602	23/99+1-6		65.0		58,028	-		3,771,820	Konfirmuar nga ZVRPP
49	Nazmie Licaj	8602	23/99+1-5		55.3		58,028	-		3,208,948	Konfirmuar nga ZVRPP
50	Bashkëpronare Lika	8602	23/99+1-3		105		58,028	-		6,092,940	Konfirmuar nga ZVRPP
51	Bashkëpronare Hasani	8602	23/99+1-4		41.5		58,028	-		2,408,162	Konfirmuar nga ZVRPP
52	Jashar Metushaj	8602	23/99+2-1		49.3		58,028	-		2,860,780	Konfirmuar nga ZVRPP
53	Bashkëpronare Kapaj	8602	23/99+2-2		39.2		58,028	-		2,274,698	Konfirmuar nga ZVRPP
54	Bashkëpronesi Selmanaj	8602	23/99+1-7		62.5		58,028			3,626,750	
55	Bashkëpronesi Balili, Hodaj dhe Hamzai	8602	27/53		168		58,028			9,748,704	Saktesim dokumentacioni
56	Luan Fetahu	8602	31/183-Nd.		87.4				4,741,785		Saktesim dokumentacioni
				11,786	2,339.1			119,912,290	35,785,520	94,003,039	249,700,848
									TOTALI		249,700,848

(Zona II, Shkolla e Marinës~ Uji I Ftohte)

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi		Vlera			SHËNIME
						Leke/m ²		Leke			
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Ndërtesë	Banesë	
1	Zinie Kenella	8602	40/94	351		10,174		3,571,074		-	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Bashkpronesi Koleka, Kojana	8602	40/124	1211		10,174		12,320,714		-	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Bashkëpronesi Koleka, Kojana	8602	41/5	1891.4		10,174		19,243,104		-	Saktesim dokumentacioni
4	Jahja Mici	8602	77/5	1012.1		10,174		10,297,105		-	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Hamide Seni	8602	79/2	669.2		10,174		6,808,441		-	Saktesim dokumentacioni
6	B.P. Papalilo	8603	41/171	549		10,174		5,585,526		-	Saktesim dokumentacioni
7	Hamdi Çarcani	8602	41/199	69.42	53.29	10,174	60,607	706,279		3,229,747	Sktesim dokumentacioni
8	Bashkëpronesi Gjika	8602	41/169	2059.8		10,174	60,607	20,956,405		-	Sktesim dokumentacioni
9	Sheme Gjonzeneli	8602	41/236	80		10,174		813,920		-	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Zenel Mjalti	8602	41/238-Nd		93.72		60,607	-		5,680,088	Sktesim dokumentacioni
11	Cane Metaj	8602	41/239-Nd		152.21		60,607	-		9,224,991	Sktesim dokumentacioni
12	Simon Rrapi	8602	41/168-Nd		55.04		60,607	-		3,335,809	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Hajrie Meksi	8602	41/241-Nd		122.54		60,607	-		7,426,782	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Gent Sinani	8602	42/40-Nd.		54.18		60,607	-		3,283,687	Konfirmuar nga ZVRPP
				69	69	10,174		702,006	2,099,598		
15	Bashkëpronesi Sinani	8602	42/40	468.32	70.6	10,174	60,607	4,764,688		4,278,854	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Bashkëpronesi Sinani	8602	42/40		220.38		60,607			12,621,499	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Bashkëpronesi Sinani	8602	42/41	525.8		10,174		5,349,489		-	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Selim Gjondeda	8602	42/72	498.9		10,174		5,075,809		-	Sktesim dokumentacioni
19	Skender Racaku	8602	42/370-Nd		20		60,607	-			Konfirmuar nga ZVRPP
20	Albert Dema	8602	42/286-Nd		12		60,607	-		727,284	Konfirmuar nga ZVRPP



21	Bedri Alla	8602	42/307	104.7		10,174		1,065,218		-	Sktesim dokumentacioni
22	Rahim Mazaj	8602	35/2-Nd		121.4			-	3,073,562	-	Sktesim dokumentacioni
23	Cenaj & CO	8602	36/22	582.1		10,174		5,922,285		-	Sktesim dokumentacioni
24	Neta Hasanaj	8602	36/29	22.55	6.3	10,174	60,607	229,424		381,824	Sktesim dokumentacioni
25	B.P Vokopola	8602	36/248	295.88		10,174		3,010,283		-	Sktesim dokumentacioni
26	B.P Vokopola	8602	36/88	1035		10,174		10,530,090		-	Konfirmuar nga ZVRPP
27	B.P Vokopola	8602	36/254	450		10,174		4,578,300		-	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Bashkëpronaret Gjyli	8602	40/266	308		10,174		3133592		-	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Arjan Lengu	8602	36/14	32.78	32.78	10,174		5911094	1,301,465		Sktesim dokumentacioni
30	B.P. Meksi, Zotaj, Gjondeda	8602	41/168	628		10,174		5911094			Sktesim dokumentacioni
				12,606	1,083.4			136,485,940	6,474,625	50,190,566	193,151,131
									TOTALI		193,151,131
TOTALI (zona I+zona II)										442,851,979	

**VENDIM****Nr. 662, datë 8.10.2014****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR HAPJEN
DHE PËR MBYLLJEN E
INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PARAUNIVERSITARE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 41, pika 1, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike.

A. HAPJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE

1. Në kuptim të këtij vendimi, “Hapja e institucionit arsimor publik” është procesi i ngritjes dhe funksionimit, për herë të parë, e njërit prej institucioneve arsimore parauniversitare publike të mëposhtme:

- a) Kopsht (arsimi parashkollor);
- b) Shkollë e arsimit fillor;
- c) Shkollë e arsimit të mesëm të ulët;
- ç) Shkollë e arsimit të mesëm të lartë, që është në juridiksionin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

2. Nisma për hapjen e një institucioni arsimor parauniversitar publik mund të merret nga:

- a) njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
- b) njësia përkatëse arsimore vendore;
- c) komuniteti i zonës, ku pritët të hapet institucioni arsimor parauniversitar publik.

3. Kur nisma për hapjen e një institucioni arsimor parauniversitar publik merret nga komuniteti i zonës, ku pritët të hapet institucioni arsimor, përfaqësuesit e tij i paraqesin kërkesë me shkrim kryetarit të këshillit përkatës të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe titullarit të njësisë përkatëse arsimore vendore. Në këtë kërkesë parashtrihen arsyet e nismës dhe kontributet e mundshme të tyre për funksionimin e institucionit arsimor.

Kryetari i këshillit përkatës të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe titullari i njësisë përkatëse arsimore vendore shqyrtojnë kërkesën e komunitetit.

4. Kryetari i këshillit përkatës të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe titullari i njësisë përkatëse arsimore vendore, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të zonës, i paraqesin ministrit përgjegjës për arsimin propozimin për hapjen e institucionit arsimor publik.

5. Propozimi për hapjen e një institucioni arsimor parauniversitar publik shoqërohet me këto dokumente:

a) Argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së institucionit arsimor publik.

b) Të dhëna për kontributin e njësisë bazë të qeverisjes vendore.

c) Të dhëna për kontributin e komunitetit të institucionit arsimor publik ose të biznesit /partnerëve socialë, ku pritët të hapet institucioni arsimor.

ç) Të dhëna për përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikën 7, të këtij vendimi.

6. Propozimi për hapjen e një institucioni arsimor publik parauniversitar paraqitet jo më vonë se:

a) 3 (tre) muaj para fillimit të vitit mësimor, kur institucioni hapet në një godinë ekzistuese;

b) 1 (një) vit kalendarik para fillimit të vitit mësimor, kur nevojitet godinë e re shkollore.

7. Institucioni arsimor parauniversitar publik hapet kur plotësohen këto kriterë:

a) Ndërtesa dhe mjediset e saj plotësojnë kushtet për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

b) Ndërtesa e institucionit arsimor dhe mjediset e saj plotësojnë standardet, sipas legjislacionit në fuqi.

c) Sigurohen, sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet e mëposhtme:

- i) furnizim me ujë;
- ii) ngrohje;
- iii) furnizim me energji elektrike;
- iv) komunikim telefonik dhe interneti.

ç) Pajisja me mjete mësimore për funksionimin normal të procesit të mësimdhënies dhe nxënies është e mjaftueshme.

d) Numri i nxënësve për klasë është sipas standardeve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.



dh) Ngarkesa mësimore e mësuesve është sipas standardeve të përgjithshme të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

e) Drejtuesit dhe personeli mësimor plotësojnë kriteret profesionale përkatëse të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

8. Ministri përgjegjës për arsimin vendos për hapjen ose jo të një institucioni arsimor parauniversitar publik pas verifikimit të bërë nga njësia arsimore vendore përkatëse për përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikën 7, të këtij vendimi.

B. MBYLLJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE

1. Në kuptim të këtij vendimi, “Mbyllja e institucionit arsimor publik” është procesi i mbylljes së institucionit arsimor parauniversitar publik.

Nisma për mbylljen e një institucioni arsimor publik mund të merret nga:

- a) njësia bazë përkatëse e qeverisjes vendore;
- b) njësia arsimore përkatëse vendore;
- c) përfaqësuesit e komunitetit të institucionit arsimor publik (bordi i institucionit dhe këshilli i prindërve).

2. Për mbylljen e një institucioni arsimor publik parauniversitar, kryetari i këshillit përkatës të njësise bazë të qeverisjes vendore dhe titullari i njësise përkatëse arsimore vendore i paraqesin ministrit përgjegjës për arsimin propozimin për mbylljen e institucionit arsimor publik, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të zonës ku ndodhet institucioni arsimor publik.

3. Propozimi për mbylljen e një institucioni arsimor publik shoqërohet me këto dokumente:

- a) Argumentimin e domosdoshmërisë së mbylljes së institucionit arsimor;
- b) Mundësitë konkrete të transferimit të nxënësve të institucionit që do të mbyllet në një institucion tjetër arsimor parauniversitar publik;
- c) Procedurat e transferimit të nxënësve të institucionit që do të mbyllet në një institucion tjetër/institucione të tjera arsimore publike;
- d) Përcaktimin e destinacionit të inventarit të orendive, mjeteve mësimore etj. të institucionit;
- d) Përcaktimin e mundësive për punësim të personelit të institucionit arsimor që mbyllet.

4. Mbyllja e institucionit arsimor publik bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit,

njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe njësitë arsimore vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 664, datë 8.10.2014

PËR VENDOSJEN E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK NË VARËSI TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik në varësi të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2. Vendimi nr. 1041, datë 14.10.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik në varësi të ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 665, datë 8.10.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 541, DATË 7.8.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR DISA INSTITUCIONE, PËR FESTIMET E 70-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit



nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e vendimit nr. 541, datë 7.8.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Policia e Shtetit”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dekorimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit me rastin e 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 666, datë 8.10.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA AUTORITETI
SHTETËROR PËR INFORMACIONIN**

GJEOHAPËSINOR (ASIG) TE

**KËSHILLI I MINISTRAVE, PËR
AGJENCINË E MBËSHTETJES SË
SHOQËRISË CIVILE, TË GODINËS SË
OBSERVATORIT TË INSTITUTIT TË
GJEOSHKENCAVE DHE ENERGJISË,
UJIT E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme

të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) të Këshilli i Ministrave, për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.


2. Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


3. Vendimi nr. 771, datë 5.9.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) të një pjese të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile dhe kryeregjistruesi i i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 44 lekë